



RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS

MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Fizikë
Projektpropozimi	Vlerësimi i proceseve të emacionit, transportit, difuzionit dhe ekshalacionit në daljen e radonit nga Toka
Kandidati/ja	Fatime Limani
Mentori	Prof. Dr. Skender Kabashi
Aprovimi i projekt propozimit	Date: 03.07.2024
në Këshillin e Fakultetit	Vendimi nr. 2274

Dorëshkrimi i kandidatës Fatime Limani fillon me hyrjen, ku tregohet për rëndësinë e një hulumtimi të këtij lloji.

Materiali në kapitullin e parë përmban aspektin teorik të punimit, duke filluar me vetitë fizike dhe kimike të radonit, izotopet e tij dhe produktet e zbërthimit, aspektet e përqendrimeve të radonit dhe limitet e dozave që sjellin në dozën totale të pranuar nga radoni dhe tregatimi.

Kapitulli i dytë "Dalja e radonit nga Toka në ajër", përshkruan proceset e prejaradhjes së radonit dhe proceset që çojnë në daljen e tij në ajër, si dhe hyrja e radonit brenda objekteve të mbyllura. Kapitulli i tretë "Materialit dhe Metodat", përshkruan metodat e matjeve dhe saktësinë e tyre, duke u përqendruar në procedurat standarde të matjeve dhe ato të përdorura në këtë punim.

Kapitulli i katërtë paraqet rezultatet e arritura, duke përshkruar lokacionet e përfshira në hulumtim, rezultatet veç e veç në mënyrë tabelare dhe grafike dhe diskutimet e rezultateve. Punimi përmbyllet me përfundimet e nxjerra nga rezultatet e arritura, disa rekomandime dhe

krahasimet me rezultatet nga hulumtimet tjera.

Prandaj, duke u bazuar në përshkrimet e dhëna më lartë, dhe pas analizës së tërë materialit të punimit, komisioni për vlerësim të dorëshkrimit dhe mbrojte të temës master, bazuar në Kërkesën nr.1468, të datës 14.05.2025 për temën “*Vlerësimi i proceseve të emanacionit, transportit, difuzionit dhe ekshalacionit në daljen e radonit nga Toka*” të kandidatës Fatime Limani, në përputhje me procedurat e rregullores së studimeve master, paraqet këtë:

Vlerësim të dorëshkrimit

Kandidatja Fatime Limani, temën e nivelit master e ka shkruar në përputhje me kriteret akademike dhe të parapara me rregullore. Tërë materialin e ka shtri në 59 faqe, të sistemuar në 4 kapituj. Materialit i paraprinë: deklarata e betimit, falënderimi, përmbajta, abstrakti, lista e tabelave dhe lista e figurave. Ndërsa përfundon më referencat. Kandidatja në hulumtim ka shfrytëzuar një numër të konsiderueshëm të literaturës aktuale, ndërsa për shtjellim të temës ka ndërtuar tabela dhe figura të shumta. Formulatat, tabelat dhe figurat janë kompatible me tekstin. Shtrimi dhe shtjellimi i temës është në përputhje me normat pedagogjike dhe hulumtuese.

Komisioni mendon se me qëllim të rritjes së kualitetit të punimit, kandidatja duhet të bëjë edhe këto përmirësime:

1. Kapitulli 3 duhet të jetë: Materiali dhe Metodat
2. Kapitulli 4 bëhet: Rezultatet dhe diskutimet.
3. Tek “Përfundimi”, të paraqiten disa të dhëna, të bazuara në rezultatet e punimit.

Prishtinë, 22.05.2025

Komisioni:

1. _____

/ Prof. Dr. Naim Syla – kryetar/

2. _____

/ Prof.Dr. Skender Kabashi – anëtar / (mentor)/

3. _____

/ Prof. Asoc.Dr. Gazmend Nafezi – anëtar